



Republika e Kosovës
Republika Kosovo – Republic of Kosovo
Kuvendi – Skupština – Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal
Mbledhja nr.53/2018
Prishtinë, më 27.12.2018, në orën 10:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Sala Berisha Shala, kryetare, Lutfi Zharku, Hykmete Bajrami, Muharrem Nitaj, Veton Berisha dhe Duda Balje, anëtarë.

Munguan: Dardan Sejdiu, zëvendëskryetar i parë, Adem Hoxha, zëvendëskryetar i dytë, Memli Krasniqi, Glauk Konjufca dhe Liburn Aliu, anëtarë.

Pjesëmarrës tjerë: Donika Bekteshi – KDI, Liridon Gashi – SEEF, Vatra Qehaja - LVV, si dhe përfaqësues të mediave.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Muhamet Morina, Besim Haliti dhe Veton Raci.

Mbledhjen e kryesoi: Sala Berisha Shala, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.12.2018;
3. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2018;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Hykmete Bajrami, tha se kam kërkuar të ftohen përfaqësuesit e ZRRE-së, që të njoftohemi me masat e marra për reduktimet e ashpra me energji elektrike në këtë kohë nga ana e KEDS-it.

Muharrem Nitaj, tha se është koha e shkurtër për të realizuar një takim të tillë, por pasi që situata është emergjente, edhe ne duhet të veprojmë me shpejtësi. Është mirë të kemi një qëndrim të përbashkët si Komision, për çështjen e çmimeve të derivateve të naftës.

Veton Berisha, tha se e përkrahë propozimin e kolegëve, por, se nuk mund të kemi qëndrim të përbashkët, pa i dëgjuar palët, pas takimit me palët përgjegjëse, mund të dalim me një qëndrim të përbashkët.

Duda Balje, theksoi se pajtohet me kolegët që të kemi një takim për të diskutuar sidomos rreth çështjes së reduktimeve me energji elektrike.

Kryetarja, theksoi se gjendja me reduktimet e energjisë elektrike në këtë periudhë është shqetësim për të gjithë ne. Nuk varet vetëm nga ne, kur dëshirojmë të kemi në komision përfaqësues të institucioneve të ndryshme, sepse siç e dimë ata kanë edhe agjenda të tjera. Po ashtu, deputetja Bajrami kërkoj që të ftohet edhe ministri Pal Lekaj dhe ministri Besim Beqaj, dhe për shkak të agjendave të tyre, s'kanë mundur të jenë në Komision, përveç asaj, që tani jemi në kohë festash, por nëse pajtohet komisioni, mund të mbajmë edhe një takim.

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 13.12.2018;

Procesverbali i datës 13.12.2018 u miratuan pa vërejtje.

3. Miratimi i Raportit vjetor të Punës së Komisionit për vitin 2018;

Kryetarja, tha se komisioni që udhëheq, ka arritur qe suksesshëm të përmbush planin e punës dhe synimet për vitin 2018. Me poshtë, ajo paraqiti në pika të shkurtra aktivitetin përmbledhës të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal. Komisioni realizoi 116 (njëqindëgjatëmbëdhjetë) aktivitete këtë vit. Komisioni gjatë këtij vitit 2018, në tërësi i ka realizuar aktivitetet e planifikuara në planet e tij të punës, përveç se nuk është përfunduar puna e Projektstatutit të Trepçës, si dhe mospërfundimi i punës së monitorimit të Ligjit për Energji Elektrike. Komisioni ka shqyrtuar/trajtuar apo ka në shqyrtim/trajtim 45 lëndë, dhe ka realizuar 116 aktivitete, si mbledhje, dëgjime publike, grupe pune, vizita, takime etj., të paraqitura në shifra, si vijon: 22 Projektligje të shqyrtuara dhe miratuara, 1 Projektstatut në procedure, 330 amendamente, 16 raportime të ministrave apo zv. ministrave, 8 Raporteve të Agjencive të pavarura, 31 Rekomandime, 15 Vendime, 7 Kërkesa të institucioneve publike dhe private, 43 mbledhje të rregullta, 16 Grupe pune, 29 mbledhje të grupeve të punës, 3 Dëgjime Publike, 1 Punëtori, 6 Vizita brenda vendit, 8 vizita jashtë vendit,

26 takime të tjera. Më këtë rast ajo falënderoi deputetët si të pozitës ashtu edhe ata të opozitës për angazhimin, shoqërinë civile për propozime si dhe stafin mbështetës të Komisionit.

Muharrem Nitaj, tha pas prezantimit të këtyre aktiviteteve dhe pasi kemi marrë edhe kopje të këtij raporti, nuk mbetet diç tjetër veçse ta miratojmë.

Veton Berisha, tha se nëse ka çmim për vlerësim të punës së komisioneve, unë do t'ia kisha nda komisionit tuaj për punën profesionale që bëni, sidomos administrata që është shumë profesionale.

Lutfi Zharku, kërkoi të ketë projekt- statusin për Trepçën, pasi në këtë Komision nuk jam nga fillimi i mandatit dhe nuk e kam.

Pas diskutimeve komisioni njëzëri nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Raporti i Punës së Komisionit për vitin 2018.

4. Të ndryshme. Çështjet vijuese.

Hykmete Bajrami, kërkoi të mbahet një mbledhje tjetër gjatë ditës së nesërme, për të diskutuar rreth problemeve të reduktimeve të energjisë elektrike dhe çmimeve të larta të naftës.

Pas diskutimeve komisioni njëzëri vendosi që në mbledhjen e radhës të ftohen përfaqësuesit e institucioneve ligjzbatuese, në lidhje me ndërprerjet e energjisë elektrike dhe çmimin e naftës.

Kryetarja, njoftoi deputetët për realizimin e udhëtimit zyrtar në Shkup, Maqedoni, më 26-28 nëntor 2018, lidhur me pjesëmarrjen në “Mbledhjen e Plenumit Parlamentar të Komunitetit të Energjisë” dhe Forumin e Dytë Parlamentar të Evropës Juglindore, me temë: “Eficienca e energjisë dhe klima”. Po ashtu, ajo i njoftoi deputetët edhe për realizimin e udhëtimit zyrtar në Podgoricë të Malit të Zi, më 3-5 dhjetor 2018, me temën; “Shkëmbim eksperiencash për Eficiencën Energjisë për rajonin dhe Kosovën pas vitit 2020”. Gjithashtu, ajo njoftoi edhe për vizitën e realizuar në KEK, ku tha se është problematike mungesa e deputetëve të tjerë në këtë vizitë dhe vizitat tjera të ndërmarrjeve publike dhe institucioneve tjera, që i raportojnë këtij Komisioni.

Mbledhja përfundoi në orën 11:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Sala BERISHA SHALA